

**RAPORT VJETOR  
PËR AKTIVITETIN AFARIST TË  
FONDIT PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE  
PËR VITIN 2020**

**Shkup, shkurt 2021**

## Përmbajtja

<b>REZIME .....</b>	<b>3</b>
<b>I. LËVIZJA E DEPOZITAVE TË POPULLATËS NË SISTEMIN BANKAR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT GJATË VITIT 2020 .....</b>	<b>5</b>
<b>II. PORTOFOLI INVESTUES I FONDIT (01.01.2020 – 31.12.2020).....</b>	<b>13</b>
<b>III. KOMENZIMI I DEPOZITUESËVE TË ANËTAREVE TË FONDIT TEK TË CILAT KA NDODHË RASTI I RREZIKUT (FALIMENTIM OSE LIKUIDIM) .....</b>	<b>16</b>
<b>IV. REZULTATET FINANCIARE PËR VITIN 2020.....</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>V. AKTIVITETE AFARISTE TË FONDIT GJATË VITIT 2020 .....</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>ORGANET DREJTUESE .....</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>AKTET E MIRATUARA.....</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>ORGANIZIMI TEKNIK DHE KADROVIK.....</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>PROCESE AFARISTE NË FONDIN PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE .....</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>BASHKËPUNIMI NDËRKOMBETAR .....</b>	<b>28</b>
<b>MARDHËNIE ME PUBLIKUN .....</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
<b>AKTIVITETE TË TJERA TË FONDIT PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE .....</b>	<b>30</b>

## REZIME

Jashtë të gjitha parashikimeve politike, ekonomike dhe sociale, pa pritur aspak viti 2020 do të mbahet mend si viti më i vështirë me të cilin u ballafaqu botë pas Luftës së Dytë Botërore, për arsye të përhapjes së smundjes ngjitëse COVID 19, e cila shkaktoi krizë botërore shëndetësore, ekonomike dhe financiare. Për fat të keq, kjo smundje vazhdon të ndikoj në të gjitha sferat e jetës shoqërore në të gjitha shtetet e botës, pa marr parasysh shkallën e tyre të zhvillimit.

Si pasojë e luftës me COVID 19 dhe krizës ekonomike dhe financiare me të cilën u ballafaqua ekonomija në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shkalla e rritjes së bruto prodhimit -vendor për vitin 2020 në Maqedoninë e Veriut është negative dhe paraqet – 4,4%<sup>1</sup>. Treguesët makroekonomikë të cilët shënojnë vitin 2020 janë inflacioni prej 1,2% në 2020, krahasuar me 0,8% për vitin 2019. Shkalla e papunësisë në vitin 2020 paraqet 16,6%, dhe është më e vogël se 0,7% në raport me shkallën e papunësisë për vitin 2019, shkalla e punësisë në vitin 2020 paraqet 47,5% dhe është 0,2% më e lartë se shkalla e punësisë në vitin 2019<sup>2</sup>. Rroga mesatare e paguar si bruto-rrogë për një të punësuar në nëntor të vitit 2020, paraqet 41.141 denar<sup>3</sup>.

Në prill të vitit 2020, Fondi lidhi Memorandum për bashkëpunim me qëllim të mbajtjes së stabilitetit financiar me Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministrinë e Financave, Komisionin për Letra me Vlerë, Agjensionin për Supervizion të Sigurimeve dhe Agjensionin për Supervizion të Kapitalit Financiar të Sigurimit Penzional me qëllim të realizimit, kordinimit dhe identifikimit efikas në kohë të rreziqeve sistematike nga ana e trupave regullatore që të ndërmerren veprime të përbashkta për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit të tyre ndaj sistemit financiar.

Ngjarja më e rëndësishme e cila e shënoi punën e Fondit për Sigurimin e Depozitave në vitin 2020, ishte rasti i rrezikut i cili ndodhi më 12.08.2020, kur guvernatorja e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ia morri lejen e punës „Eurostandard bankës” SHA Shkup, anëtare e Fondit për Sigurimin e Depozitave. Pagesa e kompezimit të 137.107 depozitorëve me të drejtë kompenzimi i cili filloi më 15.09.2020, nëpërmjet katër bankave – paguese. Deri më 31.12.2020 ishin paguar 85,1% nga gjithë kompenzimi i përlogaritur në „Eurostandard bankë” SHA Shkup në falimentim dhe atë për 10.800 depozitor.

Duke pasur parasysh krizën botërore e cila nuk i anashkaloj as amvisritë dhe ekonominë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, rritja e depozitave të popullatës prej 4,2% për vitin 2020, edhe pse është më e ulët se në tre vitet e fundit, është pozitive dhe inkurajuese<sup>4</sup>. Më 31.12.2020, vlera e depozitave të përgjithshme paraqite 295,7 miliard denar ose 4,8 miliard euro, prej të

<sup>1</sup> Burimi :Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut

<sup>2</sup> Burimi: Ministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut

<sup>3</sup> Burimi : Enti Shtetëror i Statistikës

<sup>4</sup> Gjegjësisht, në tre vitet e fundit, rritje më e madhe e depozitave të popullatës është shënuar në vitin 2018 në vlerë prej 9,1% në nivel vjetor (2019: 7,4%).

cilave 52,5% janë depozita në denar, ndërsa 47,5% janë depoizita devizore. Pagesa e premive në vitin 2020 realizoheshte me normë prej 0,25% në nivel vjetor. Premitë përlllogariten në bazë të lëvizjes së depozitave të përgjithshme të popullatës.

Portofoli investues i Fondit për vitin 2020 u zvogëlua për 18,9% në krahasim me vitin 2019 për arsye të kompenzimit të rastit të rrezikshëm në „Eurostandard bankë” SHA Shkup në falimentim. Më 31.12.2020, portofoli i përgjithshëm investues paraqiste 13.936,2 milion denar sipas vlerës së tyre nominale gjegjësisht 13.930,2 milion denar vlerë e tanishme. Fondi gjatë vitit 2020 morri pjesë në 14 aukcione të bonove të thesarit shtetëror të Ministrisë së Financave.

Fondi në qershor të vitit 2020, nëpërmjet lidhjes online kishte prezentimin e rezultateve të veta nga realizimi i hulumtimit të mendimit publik në suaza të mbledhjes së Komitetit për Mardhënie me Publikun pran Forumit Evropian të Sigurimit të Depozitave (EFDI).

Si anëtare aktive e EFDI, Fondi morri pjesë në Kuvendin Vjetor të rregullt të EFDI-së i cili gjithashtu u mbajtë online.

Fondi për Sigurimin e Depozitave morri pjese online në manifestimin e Ditës botërore të kursimit si organizatore me nëpërmjet bashkëpunimit me Asociacionin Bankar Maqedonas.


в.д. Директор, u.d Drejtori  
Amir Shabani

## I. LËVIZJA E DEPOZITAVE BANKARE TË POPULLATËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2020

Vlera e përgjithshme e depozitave të popullatës në sektorin bankar të Republikës së Maqedonisë së Veriut në fund të muajit dhjetor të vitit 2020 paraqiste 295,7 miliard denar (4,8 miliard euro). Lëvizjet mujore të depozitave të përgjithshme të popullatës në sektorin bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë të treguara në Grafikonin nr.1 ose të ndara në muaj në Tabelën nr.1. Rritja vjetore e depozitave paraqet 4,2%, nga të cilat peshë më të madhe ka rritja e depozitave prej 2,2% në muajin dhjetor të vitit 2020, praktikë e një numri më të madh bankash në vitet e fundit.

Rritja prej 4,2% në nivel vjetor është më e vogël se sa rritja e depozitave të popullatës e realizuar në vitin 2019 (7,4%) thjesht për shkak të krizës së madhe botërore, si pasojë e shkaktuar nga pandemia e smundjes ngjithëse COVID19. Sipas analizave është konstatuar se depozitat e paafatizuara në dhjetor të vitit 2020 kanë rritje prej 19,1% krahasuar me të njëjtat në dhjetor të vitit 2019, ndërsa depozitat e afatizuara kanë rënie prej 7,1%. E shprehur në përqindje depozitat e afatizuara në depozitat e përgjithshme të popullatës më 31.12.2020 marrin pjesë me 50,7% gjegjësisht depozitat e paafatizuara paraqesin 49,3%. Në aspekt të strukturës valutore, depozitat në denar kanë rritje prej 2,9% ndërsa depozitat devizore rritje prej 5,6% krahasuar me dhjetorin e vitit 2019.

Grafikoni 1. Lëvizjet mujore të depozitave të popullatës gjatë vitit 2020



Burimi: Të dhëna administrative të FSD

Tabela 1. Lëvizjet mujore të depozitave të popullatës gjatë vitit 2020


(në një mijë denar)

Periodha	Projektme për lëvizjen e depozitave të popullatës në RMV në pajtim me planin Financiar për vitin 2020	Projektme për rritje mujore për depozitat e përgjithshme të popullatës për vitin 2020 (në përqindje)	Depozitat e përgjithshme në RMV në vitin 2020	Rritje mujore e depozitave të popullatës gjatë vitit 2020 (në përqindje)
31.12.2019	284.647.045		283.786.050	
31.01.2020	283.508.457	-0,40	283.911.635	0,04
29.02.2020	285.776.524	0,80	286.376.205	0,87
31.03.2020	286.633.854	0,30	286.532.439	0,05
30.04.2020	288.640.291	0,70	288.045.821	0,53
31.05.2020	290.372.133	0,60	288.879.724	0,29
30.06.2020	291.533.621	0,40	291.266.794	0,83
31.07.2020	293.574.356	0,70	292.696.860	0,49
31.08.2020	295.042.228	0,50	286.668.487	-2,06
30.09.2020	296.812.482	0,60	289.300.257	0,92
31.10.2020	297.702.919	0,30	288.557.387	-0,26
30.11.2020	299.786.839	0,70	289.420.071	0,30
31.12.2020	308.780.445	3,00	295.686.631	2,17
		<b>8,20</b>		<b>4,17</b>

Burimi: Të dhëna administrative të FSD

Para fillimit të pandemisë në muajt janar dhe shkurt të vitit 2020, rritja mujore e depozitave të popullatës paraqite 0,04% (dhjetor 2019:janar 2020) dhe 0,87% (janar 2020:shkurt 2020). Gjatë vendosjes së masave të para për mbrojtje nga përhapja e smundjes ngjitëse COVID 19, në mars të vitit 2020, në mars të 2020, rritja mujore paraqite 0,05% ( shkurt2020: mars 2020), ndërsa në prill të 2020 shënohet rritje minimale prej 0,53%( mars2020: prill2020). Në muajin maj 2020, rritja e depozitave paraqet 0,29%(prill2020: maj 2020), në qershor 0,83%(maj2020:qershor2020) dhe në qershor të vitit 2020 0,49% (qershor2020:korrik2020). Në gusht të vitit 2020 është shënuar rënia më e madhe prej -2,1% (korrik2020:gusht2020), e cila ka të bëjë me rastin e rrezikut i cili ndodhi në „ Eurostandard bankë” SHA Shkup në falimentim. Pas kësaj ngjarje në shtator të vitit 2020 ka rritje prej 0,92% ( gusht2020: shtator2020), dhe sërish rënie në tetor të vitit 2020 prej -0,26%, që mund të jetë si pasoj e valës së madhe e të infektuarëve të rinj me COVID 19 në atë periudhë. Në muajt nëntor 2020 dhe dhjetor 2020 ka sërish stabilizim të rritjes së depozitave të përgjithshme të popullatës dhe atë 0,30% në nëtor 2020(tetor2020: nëntor2020) dhe 2,17% në dhjetor 2020(nëntor2020:dhjetor 2020).


Grafikon 2. Rritje e depozitave sipas muajëve gjatë vitit 2020



Burimi : Të dhëna administrative të FSDA

Rritja vjetore e depozitave të përgjithshme të popullatës në sistemin bankar të Republikës së Maqedonisë së Veriut në tre vitet e fundit është treguar në Grafikonin nr.3.

Grafikon 3. Rritje vjetore e depozitave 2018-2020




Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Analiza e depozitave të popullatës në aspektin e strukturës valutore tregon se në janar dhe shkurt të 2020, para fillimit të pandemisë, ka rritje të depozitave devizore, por në mars të 2020, me vendosjen e masave të para kufizuese për mbrojtje shëndetësore të popullatës shënohet rënie prej -0,58% e depozitave devizore (shkurt2020:mars 2020). Më pas, deri në gusht 2020 depozitat devizore shënojnë rritje. Në gusht të 2020 kur ndodhi rasti i rrezikut në „Eurostandard bankë” SHA Shkup në falimentim sërisht shënohet rënie prej 0,47% ( korrik2020:gusht2020). Pas kësaj ngjarje, rritja e depozitave devizore stabilizohet dhe paraqet 0,49% në dhjetor2020 (nëntor2020:dhjetor2020). Depozitat në denar kanë rënie të zakonshme prej -1,25% në janar të 2020 (dhjetor2019:janar2020), por rënie më të madhe prej 3,5% në gusht të 2020, që gjithsesi ka të bëjë me mbylljen e „Eurostandard bankës” SHA Shkup në falimentim. Në shtator të vitit 2020

shënohet stabilizim i rritjes së depozitave në denar dhe atë 1,2% (gusht2020:shtator2020) dhe sërish rënie prej 0,73% në tetor 2020, që mund të jetë si pasojë e valës së madhe e të infektuarëve të rinj me COVID 19 në atë periudhë (sikuar qartë edhe në rritjen e depozitave të përgjithshme të popullatës në atë periudhë). Pastaj vjen deri tek stabilizimi i rritjes dhe atë ajo është më e madhe në dhjetor 2020 në arrin 3,73%. Kjo rritje shënohet çdo vjet për arsye të pagesës së parakohëshme të penzioneve për muajin dhjetor.


Grafikoni 4. Lëvizja e depozitave në denar dhe devizë në vitin 2020



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Depozita në denar në depozitat në përgjithshme të popullatës deri më 31.12.2020 paraqesin 52,5%, për kundërt 47,5% të depozitave të përgjithshme devizore për vitin 2020 (Grafikoni 5).

Grafikoni 5. Pjesëmarrje e depozitave të përgjithshme të popullatës në deviza dhe atyre në denar gjatë vitit 2020




Burimi : Të dhëna administrative të FSD



Sipas afatizimit, depozitat e paafatizuara kanë rritje prej 19,1% ndërsa ata të afatizuarat kanë rënie prej -7,1% krahasuar me vitin 2019. (Grafikoni 6).

Grafikoni 6. Lëvizja e depozitave të paafatizuara dhe afatizuara në vitin 2020

(në një mijë denar)




Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Pjesmarrje e depozitave të përgjithshme të popullatës të paafatizuara më 31.12.2020 paraqet 49,26%, ndërsa pjesëmarrja e depozitave të afatizuara në depozita e përgjithshme të popullatës deri më 31.12.2020 paraqet 50,74%. Në Grafikonin nr.7 është paraqitur pjesëmarrja e depozitave të paafatizuara dhe atyre të afatizuara të depozitave të përgjithshme të popullatës në tre vitet e fundit: 2018, 2019 dhe 2020.

Grafikon 7. Paraqitja e depozitave të paafatizuara dhe afatizuara në depozitat e përgjithshme të popullatës në vitin 2018, 2019 dhe 2020


(në përqindje)



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Vlera(shuma) e kompensimit në pajtim me Ligjin e Fondit për Sigurimin e Depozitave është 30.000 euro në kundërvlerë me denarin për një depozitues për bankë ose shtëpi kursimi. Në Shtojcën nr. 1 të këtij raporti janë treguar lëvizjet tremujore të depozitave të përgjithshme të popullsisë të klasifikuara sipas pragut ligjor për kompensim në vlerë prej 1,85 milion denar ose 30.000 euro në kundërvlerë me denarin. Analiza e depozitave të popullsisë në pajtim me shumën e kompensimit tregon se pjesëmarrja e depozitave të popullsisë **deri në 30.000 euro** në depozitat e përgjithshme të popullsisë është më e madhe në dy tremujorët e fundit të vitit 2020 dhe atë me 53,9%. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës është **mbi 30.000 euro** në kundërvlerë me denarin dhe është më e madhe në tremujorshin e dytë të vitit 2020 me 46,7%, ndërsa më e ulët në tremujorshin e tretë të vitit 2020 me 46,1% (Grafikoni 8)


Grafikoni 8. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës deri dhe mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin në depozitat e **përgjithshme të popullatës** (IVQ.2019 – IVQ.2020)



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Depozitat e popullatës deri dhe mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin analizohen veç e veç sipas bankave dhe shtëpitë e kursimit, dhe duke u nisur prej këtu depozitat e popullatës **deri në 30.000 euro nëpër banka** në depozitat e popullatës nëpër banka është më e madhe në dy tremujorshët e fundit të vitit 2020 me 53,8% ndërsa më e ulët në tremujorshin e dytë të vitit 2020 në 53,2%. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës **mbi 30.000euro në kundërvlerë me denarin në banka** në depozitat e përgjithshme të popullatës në banka është më e lartë në tremujorshin e dytë të vitit 2020 dhe atë me 46,8%, ndërsa më e ulët në dy tremujorët e fundit të viti 2020 me 46,2% (Grafikoni 9).


Grafikoni 9. Pjesëmarrja e depozitave të popullatës deri dhe mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin në banka depozitat e përgjithshme të popullatës në banka -anëtare të FSD (IVQ.2019 – IVQ.2020 )



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Pjesëmarrja e depozitave të popullatës **deri në 30.000 euro në shtëpi të kursimit** në depozitat e përgjithshme të popullatës në shtëpitë e kursimit është më e madhe në tremujorin e fundit të vitit 2020 me 74,2%. . Pjesëmarrja e depozitave të popullatës **mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin në shtëpitë e kursimit** në depozitat e përgjithshme të popullsisë është më e lartë në tremujorin e parë të vitit 2020 dhe paraqet 25,8%, ndërsa më e ulët në tremujorshin e fundit të 2020, 22,8% (Grafikoni 10).

Grafikoni 10. . Pjesëmarrja e depozitave të popullatës deri dhe mbi 30.000 euro në kundërvlerë me denarin në shtëpi të kursimit në depozitat e përgjithshme të popullsisë në kursimore -anëtare të FSD (IVQ.2019 – IVQ.2020)




Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Pagesa e premive në vitin 2020 zhvilloheshte sipas procedurave të rregullta, me shkallë të përcaktuar prej 0,25% në nivel vjetor.

Mjetete e përgjithshme të cilat i pagoi Fondi në vitin 2020 në bazë të premisë paraqesin 719,8 milion denar ose 11,7 milion euro (Grafikoni 11).


Grafikoni 11. Lëvizja e shumës mujore të premive në vitin 2020



Burimi : Të dhëna administrative të FSD

Norma e mbulimit të depozitave të popullatës( mjetet e përgjithshme të Fondit në lidhje me depozitat e përgjithshme të popullatës) gjatë vitit 2020 është më të mëdhe në gusht të vitit 2020 me 6,25%, ndërsa më e vogël në dhjetor të 2020 me 4,94%. Rënia e normës së mbulimit ka të bëjë me uljen e mjeteve të përgjithshme të Fondit për Sigurimin e Depozitave të cilat ishin të nevojshme për pagesën e kompensimeve të depozitorëve të „Eurostandard bankë” SHA Shkup në falimentim (Grafikoni 12).

Grafikoni 12. Lëvizja e normës së mnulimit në vitin 2020



Burimi: Të dhëna administrative të FSD

## II. PORTOFOLI INVESTUES I FONDIT (01.01.2020 – 31.12.2020)


Portofoli investues i Fondit në vitin 2020 është ulur për 18,9% në krahasim me vitin 2019, ulje të cilën e shkaktoi pagesa e kompenzimeve të rastit të rrezikut në „Eurostandard bankë” SHA Shkup në falimentimi cili ndodhi më 12 gusht të vitit 2020.

Më 31.12.2020 gjendja e përgjithshme e portofolit investues paraqiste 13.936,2 milion denar sipas vlerës së tyre nominale, gjegjësisht 13.930,2 milion denar vlera e tanishme. Në nivel vjetor shënon rënie prej 3,2 miliard denarësh gjegjësisht ulje për 18,9% krahasuar me gjendjen e portofolit investues më 31.12.2019. Portofoli investues në semestrin e parë të vitit 2020 shënoi rritje e cila korespondonte me rritjen e mjeteve të mbledhura të Fondit në bazë të premive nga ana e anëtareve të veta dhe nga të hyrat në bazë të mjeteve të investuara në letra me vlerë. Mirëpo pas rastit të rrezikshëm në muajin gusht të vitit 2020 në „Eurostandard bankë” SHA Shkup në falimentim, portofoli investues i Fondit filloi të zvogëlohet për arsye të fillimit të procesit të pagesës së kompenzimeve të depozitorëve. Kompenzimi i përgjithshëm të cilin Fondi për Sigurimin e Depozitave e pagoi në llogaritë e dedikuara në bankat pagueuse në bazë të kompenzimit të depozitorëve të „Eurostandard bankë” SHA Shkup në falimentim paraqiste përafërsisht 4,2 miliard denar dhe për arsye të kompenzimit të mjeteve Fondi bëri shitjen e bonove të thesarit shtetëror në vlerë prej 3,4 miliard denar dhe nuk morri pjesë në aukcionin e caktuar për muajin shtator të vitit 2020, për bonot e thesarit të cilat ishin në dispozicion, për çka mjetet u orjentuan në fondin rezervë për pagesën e kompenzimit të deponentëve.

Në lidhje me gjendjen e planifikuar të gjendjesë së plasmanit të bonove të thesarit shtetëror për fundin e vitit 2020 ( 18 miliard denar, shuma e tanishme, indeksi paraqet 77,4%. Analiza e Fondit për portofolin investues tregon investimin e drejtë të mjeteve të Fondit në lidhje me bonot e planifikuara në semestrin e parë të vitit 2020 nga ku indeksi i bonove të planifikuara në krahasim me bonot e investuara është identik me rritje minimale në krahasim me atë të planifikuarën për 0,4% me çka në semestrin e dytë të vitit 2020 fillon rënia e mjeteve të Fondit për arsye të pagesës së kompenzimit të depozitorëve gjë e cila ndikoj në zvogëlimin e mjeteve të investuara në krahasim me ata të planifikuarat. (Grafikon 13)

Grafikoni 13. Portofoli investues i Fondit në bono të thesarit shtetëror për vitin 2020

(në një mijë denar)



Burimi: Të dhëna administrative të Fondit

Fondi morri pjesë në gjithsej 14 aukcione të Ministrisë së Financave, në pajtim me politikën investuese të Fondit për Sigurimin e Depozitave shuma e përgjithshme e portofolit investues të Fondit u zvogëlua për 99,00% nga totali i gjendjes së mjeteve të përgjithshme dhe gjendjes së letrave me vlerë të Fondit në fund të çdo muaji, ndërsa më 31.12.2020 ky raport paraqite 95,3%. Portofoli investues i Fondit në fund të vitit është i përbër nga bono thesari me afat maturimi prej 364 ditësh. Në mënyrë shtesë, në këtë periudhë kishte edhe ndryshim të normave të interesit gjegjësiht normë interesi të bonove me afat maturimi deri në 364 ditë e cila ishte 0,5% dhe 0,6% në nivel vjetor deri në muajin tetor të vitit 2020, me çka u ulë në 0,4% dhe e njeta nuk ndryshoi deri në fund të vitit 2020. Të ardhurat totale të Fondit në bazë të kamatës nga bonot e reja të thesarit për vitin 2020 paraqesin 38 milion denar. Shpenzimet për provizion për bankat ndërmjetsuese të aukcioneve paraqet 485 mijë denar.

Tabela 2. Pasqyrë e dinamikës së bonove të thesarit shtetëror të planifikuara, të reja dhe normat e interesit për të njejtat për periudhën prej 01.01.2020 deri 31.12.2020 (në denar)

2020/muaj	Bono thesari te reja (D3) në periudhën janar- dhjetor 2020 (në vlerë nominale)			Bono thesari të planifikuara (D3) në periudhën janar- dhjetor 2020 (në vlerë nominale)			Dallimi në vlerën nominale 4-6	Indeksi 4/6	Norma e interesit të bonove të reja të thesarit			Provizioni
	data e pagesës	data e dorëzimit	D3 të reja	data e dorëzimit	D3 të dorëzuara	D3 të planifikuara			norma e interesit (%)	norma deri në arritje/	norma e interesit deri	
1	2	3	4		5	6	7	8	9	10	11	
janar			531.920.000		501.890.000	560.000.000	-28.080.000	95,0%		2.675.558	2.477.094	35.000
	29.01.2020	27.01.2021	531.920.000	29.01.2020	501.890.000	560.000.000			0,50	2.675.558	2.477.094	35.000
shkurt	12.02.2020	10.02.2021	699.510.000	12.02.2020	599.300.000	650.000.000	49.510.000	107,62%	0,50	3.518.535	3.122.213	35.000
mars	04.03.2020	03.03.2021	2.974.800.000	04.03.2020	5.024.040.000	5.110.000.000	-2.135.200.000	58,22%	0,50	14.963.244	12.414.560	35.000
	04.03.2020	03.03.2021	5.082.800.000				-27.200.000	99,47%		25.566.484	12.642.767	
		e shitur	2.108.000.000									
prill			1.810.000.000		1.700.800.000	1.770.000.000	40.000.000	102,26%		9.104.300	6.621.083	70.000
	01.04.2020	31.03.2021	610.000.000	01.04.2020	500.930.000	560.000.000	50.000.000	108,93%	0,50	3.068.300	2.309.653	35.000
	15.04.2020	14.04.2021	1.200.000.000	15.04.2020	1.199.870.000	1.210.000.000	-10.000.000	99,17%	0,50	6.036.000	4.311.430	35.000
maj			970.000.000		903.100.000	970.000.000	0	100,00%	0,60	5.849.100	3.728.000	35.000
	13.05.2020	12.05.2021	970.000.000	13.05.2020	903.100.000	970.000.000						
qershor	17.06.2020	16.06.2021	96.780.000	17.06.2020	41.990.000	100.000.000	-3.220.000	96,78%	0,60	583.583	315.842	30.000
korrik	01.07.2020	16.06.2021	360.000.000	01.07.2020	295.010.000	350.000.000	10.000.000	102,86%	0,60	2.088.000	1.091.724	35.000
gusht			0	05.08.2020	616.530.000	680.000.000	-680.000.000	0,00%	0,00	0	0	0
shtator	16.09.2020	15.09.2021	249.480.000		205.800.000	570.000.000	-320.520.000	43,77%	0,60	1.504.364	438.084	35.000
				16.09.2020	505.800.000							
				e shitur	300.000.000							
tetor			2.210.000.000		2.132.810.000	2.200.000.000	10.000.000	100,45%		8.901.880	1.667.415	70.000
	14.10.2020	13.10.2021	660.000.000	14.10.2020	592.830.000	660.000.000	0	100,00%	0,40	2.658.480	569.674	35.000
	28.10.2020	27.10.2021	1.550.000.000	28.10.2020	1.539.980.000	1.540.000.000	10.000.000	100,65%	0,40	6.243.400	1.097.741	35.000
nëntor	18.11.2020	17.11.2021	2.100.000.000		2.040.830.000	3.090.000.000	-990.000.000	67,96%	0,40	8.458.800	999.254	35.000
				18.11.2020	3.013.830.000							
				e shitur	973.000.000							
dhjetor			1.960.000.000		1.891.220.000	2.000.000.000	-40.000.000	98,00%		7.894.880	470.966	70.000
	02.12.2020	01.12.2021	940.000.000	02.12.2020	878.740.000	1.000.000.000	-60.000.000	94,00%	0,40	3.786.320	301.657	35.000
	16.12.2020	15.12.2021	1.020.000.000	16.12.2020	1.012.480.000	1.000.000.000	20.000.000	102,00%	0,40	4.108.560	169.309	35.000
<b>gjithsej:</b>			<b>13.962.490.000</b>		<b>15.953.320.000</b>	<b>18.050.000.000</b>	<b>-4.087.510.000</b>	<b>77,4%</b>		<b>78.185.011</b>	<b>45.989.002</b>	<b>485.000</b>

Burimi: Të dhëna administrative të Fondit

### III. KOMPENSIMI I DEPOZITUESVE TË ANËTAREVE TË FONDIT TEK TË CILËT KA NDODHUR RAST I RREZIKUT (FALIMENTIM OSE LIKUIDIM)

Kompensimi i depozituesve tek anëtarët e Fondit tek të cilët ka ndodhur rast i rrezikut (falimentim ose likuidim) është një nga tre aktivitetet themelore afariste të Fondit.

Që nga themelimi i Fondit në janar të viti 1997 deri më 31.12.2020 kanë ndodhur gjithsej 12 raste me rrezik. Përgjegjësia e përgjithshme e llogaritur për kompensim nga dymbëdhjetë ish anëtarët e Fondit është 5,7 miliardë denarë. Nga viti 1997 deri më 31.12.2020 janë kompensuar gjithsej 30,878 depozitues në vlerë të përgjithshme prej 4,9 miliardë denarë, që paraqet 86,5% të detyrimeve të paguara nga FSD për kompensim ndaj depozituesve. Pjesa tjetër prej 11,9% paraqet obligim për kompensim në vlerë të përgjithshme prej 0,8 miliardë denarë (Tabela 3).

Më 12 gusht të vitit 2020 ndodhi rasti me rrezik më të madhë që nga themelimi i Fondit. Gjegjesisht, atë ditë, guvernatorja e BPRMV-së ia mori lejen e punës "Eurostandard Bankës" SHA Shkup. Në momentin e marrjes së lejes së punës "Eurostandard Banka" SHA Shkup, sipas madhësisë dhe shumës së depozitave të siguruara në Fondin e Sigurimit të Depozitave, u kualifikuar si bankë e mesme.

Duke pasur parasysh kushtet specifike në të cilat ka ndodhur ky rast me rrezik, gjegjesisht në kushte të ballafaqimit me përhapjen e sëmundjes ngjitëse KOVID 19, organet drejtuese të FSD si dhe shërbimet profesionale menjëherë morën përgjegjësitë për të thjeshtuar dhe lehtësuar procesin e kompensimit. U ndërморën hapat në vazhdim:

- Me ndryshimet në Rregulloren për mënyrën dhe procedurën e kompensimit të depozituesve në rast të ndodhjes së rastit me rrezik, u krijua mundësia që administratori i falimentimit të lëshojë faktura elektronike në formën "pdf", të nënshkruara me nënshkrim digjital, ku pastaj shpërndahen në mënyrë elektronike deri te bankat – paguese. Në këtë mënyrë, u eliminua procesi i tërheqjes fizike të vërtetimeve për pronësi nga depozituesit me të drejtë kompensimi. Kështu u modernizua kjo pjesë e procesit, ku gjithashtu u shmang edhe krijimi i radhëve të gjata me prani fizike të depozituesve, e cila është në favor të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve.
- Në Rregullore gjithashtu u bënë ndryshime edhe në pjesën e shkëmbimit të informatave ndërmjet FSD dhe administratorit të falimentimit, dmth u mundësua transferimi i plotë elektronik i të dhënave përmes krijimi të fajlit „XML” i cili lehtë dhe qartë mund të



përdoret për futjen dhe paraqitjen e të dhënave nga baza e të dhënave të bankës në falimentim në bazën e të dhënave të FSD. Në këtë mënyrë lehtësohet krijimi i listës përfundimtare të depozituesve me të drejtë kompensimi dhe gjenerimin e bazave të mëtejshme me të cilat kryhet shkëmbimi tek bankat - paguese.

- Menjëherë filloi procesi i përzgjedhjes së bankës më të volitshme të cilat do të përfshihen në pagesën e kompensimit si banka – paguese. Përshkak të përhapjes dhe rrezikut të sëmundjeve dhe përshkak të numri të madh (137.107) të depozituesve me të drejtë kompensimi të cilat duhet të paguhen Fondi vendosi të zbatojë procesin e kompensimit përmes katër bankave më të mëdha në Republikën e Maqedonisë së Veriut , të cilat gjithashtu kanë rrjet të filijaleve dhe ekspoziturave në mbarë vendin: Banka Komerciale SHA Shkup, Stopanska Banka SHA Shkup, NLB Tutunska Banka SHA Shkup dhe Hallk Banka SHA Shkup.
- Lista përfundimtare e depozituesve me të drejtë kompensimi ishte në dispozicion të Fondit më 04.09.2020. Brenda 36 orëve Fondi realizoi shpërndau depozituesit sipas bankave - paguesit dhe shpërndarjen e Vërtetimeve elektronike të pronësisë së depozitave. Për shpërndarjen e depozituesve sipas bankave - paguese është përdorur një kriter i thjeshtë "shkronja e parë e mbiemrit të depozituesve sipas alfabetit cirilik".
- Pas përgatitjeve intensive, më 15.09.2020, filloi pagesa e kompensimit për depozituesit nga Eurostandard Banka SHA Shkup në falimentim.

